



**UNIVERSITETI  
ALDENT**

**KONFERENCA E**

**VI<sup>-të</sup>**

**SHKENCORE**



**BESONI TEK PROFESIONISTËT**

**20 Maj, 2022**



**UNIVERSITETI**  
**ALDENT**

**KONFERENCA E**

**VI<sup>-të</sup>**

**SHKENCORE**

**20 Maj, 2022**

---

**BESONI TEK PROFESIONISTËT**



## **Komiteti Shkencor i Konferencës:**

**Prof. Dr. Afrim Tabaku**

**Prof. Dr. Ruzhdie Qafmolla**

**Prof. Asc. Agim Shehi**

**Prof. Asc. Klodiola Dhamo**

**Prof. Asc. Entela Haloci**

**Dr. Sh. Nedime Ceka**

**Dr. Sh. Rezarta Shkreli**

**Dr. Sh. Alba Koshovari**

---

## **Komiteti Organizues:**

**Dr. Sh. Lorena Memushaj**

**Prof. Asc. Enkelejda Goci**

**Dr. Sh. Jona Keri**

**Dr. Sh. Nineta Saraçi**

**Msc. Ilva Petushi**

**Msc. Lira Iljazi**

**Msc. Ester Oshafi**

**Albina Hasa**

**Geisi Belishta**

---

**Adresa:** Rruga e Vilave, Pranë TEG, Tiranë, Shqipëri.

**Email:** info@ual.edu.al

**Web:** www.ual.edu.al

**Celular:** (+355) 69 31 81 835

## **HYRJE**

Universiteti Aldent, i mbështetur nga Komiteti Shkencor dhe ai Organizues, ka nderin të çelë konferencën e VI<sup>të</sup> Shkencore, e mbajtur në Tiranë, datë 20 Maj 2022.

Kjo konferencë ka si qëllim të mbledhë lektrore dhe studentë të disa fushave, me qëllim prezantimin me përgjegjshmëri dhe përkushtim. Konferenca është një platformë ndërdisiplinore për të siguruar një mjedis të fuqishëm të gjetjeve të kërkimit dhe inovacioneve teknologjike.

Konferenca e VI<sup>të</sup> Shkencore është e ndarë në katër sesione përkatësisht:

1. Sesioni i Shkencave Farmaceutike,
2. Sesioni i Shkencave Dentare,
3. Sesioni i Infermierisë dhe Fizioterapisë,
4. Sesioni i Teknikë Laboratori Mjekësor dhe Imazheri.

Në këtë libër abstraktesh janë publikuar 27 punime shkencore dhe studime kërkimore të punuar me profesionalizëm nga lektorë dhe studentë të udhëhequr nga stafi akademik.

Në këto përmbledhje trajtohen tema të ndryshme si: Njohuritë e pacientëve mbi përdorimin e antibiotikëve, formulime të reja dhe reaksionet e padëshiruara të barnave, teknika të reja në trajtimin e sëmundshmërive dentare, përkujdesi infermieror, pasojat e defiçensës së vitaminës D në organizëm etj.

Stafi drejtues i Universitetit Aldent ju uron punë të mbarë dhe suksese në Konferencën e VI<sup>të</sup> Shkencore.

**Dr. Lorena Memushaj**

Lektore pranë Departamentit të Farmacisë.

## **PËRMBAJTJA**

### **A. SESIONI I SHKENCAVE FARMACEUTIKE**

#### **ABSTRAKTE**

Gjendja jodike e grave në moshën riprodhuese të qytetit të Durrësit .....	7
Reaksionet e padëshiruara të barnave të lidhura me barnat antituberkulare të linjës së parë ....	8
Kontrolli i dislipidemise nepermjet suplementit ushqimor oksikol .....	9
Indeksi i masës së trupit dhe hipertensioni .....	10
Studim i përdorimit të antibiotikëve .....	11
Ushqimet probiotike, vetitë ushqyese dhe rëndësia e tyre në organizmin tonë .....	12
Sëmundjet infektive në qytetin e korçës dhe roli i shërbimit farmaceutik .....	13

### **B. SESIONI I SHKENCAVE DENTARE**

#### **ABSTRAKTE**

Silantet në parandalimin e kariesit (rishikim literature) .....	15
Implantet postextractive- raste klinike .....	16
Terapia estetike e dhembeve te perhershme te adoleshentet .....	17
Perpunimi mekanik dhe kimik, gjate trajtimit te periodontiteve kronike ne nje seance.	
Rishikim literature .....	18
Diabeti dhe ndikimi i tij në sëmundjet periodontale .....	19
Ndikimi i difenilhidantoinës në hiperplazinë gingivare.....	20
Influenca e cementeve rezinoze në ngjyrën përfundimtare të fasetave .....	21

### **C. SESIONI I INFERMIERISË DHE FIZIOTERAPISË**

#### **ABSTRAKTE**

Roli i infermierit ne anestezi.....	23
Roli infermierit te ri ne reanimacion, perqasia e mire me procedurat dhe protokollet.....	24
Pikëzimi ace dhe probabiliteti i shfaqjes së sëmundjeve kardiovaskulare .....	25
Incidenca dhe prevalenca e kancerit kolono-rektal në shqipëri. Faktorët precipitues .....	26
Menaxhimi infermior i situatave agresive në psikiatri .....	27
Tromboza e mezenterit. Shkaqet e rritjes së incidencës në shqipëri.....	28
Rëndësia e rehabilitimit fizioterapeutik në pacientët me epikondilitis (epikondilitis lateral) .	29
Efikasiteti i mobilizimit torakal (lewi mobilisation) në pacientët post covid-19.....	30

### **D. SESIONI I TEKNIKË LABORATORI MJEKËSOR DHE IMAZHERI**

#### **ABSTRAKTE**

Matja e vitaminës D në adultë.rolit dhe pasojat e defiçensës në organizëm.....	32
Veprimi baktericid dhe efektiviteti i produkteve antibakteriale .....	33
Evolimi i radioterapisë.....	34
Studim rasti: biopsia pulmonare transtorakale e udhëhequr në ct.....	35
Trajtimi radioterapeutik i nje tumori ne tru .....	36

---

## **A. SESIONI I SHKENCAVE FARMACEUTIKE**

---

### **Abstrakte**

## GJENDJA JODIKE E GRAVE NË MOSHËN RIPRODHUESE TË QYTETIT TË DURRËSIT

*ERNELA HOXHA<sup>1</sup>, ROMINA SHKURTI<sup>2</sup>, AFRIM TABAKU<sup>3</sup>*

<sup>1,2</sup> *Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri.*

<sup>2</sup> *Qendra Kerkimore Farmakoterapeutike, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri.*

**Hyrje:** Jodi është në element që luan një rol të rëndësishëm në sintezën e hormonit të gjëndrës tiroide, është esencial për shëndetin për të gjithë stadet e jetës. Një marrje e pamjaftueshme mund të shkaktojë crregullime të funksioneve të gjëndrave tiroide, gjithashtu edhe gushë, ose mund të ketë lidhje me disa vvecori klinike, si vonesë në rritje dhe zhvillim të vonuar mendor, që referohen si crregullime të deficiencës jodike (DDIs).

Deficiencia jodike dhe crregullimet e lidhura me të përbëjnë një problem të rëndësishëm të shëndetit publik që prek shunicën e vendeve, duke përfshirë rajonet e industrializuar dhe ato në zhvillim. Frekuenca dhe ashpërsia e manifestimeve të IDD janë të lidhura me shkallën e deficiencës jodike dhe moshën e subjekteve të prekur. Metoda e përcaktimit të jodit në urinë përbën indikatorin më të rëndësishëm të marrjes korente të jodit për arsye se 90% e jodit të dietës ushqimore ekskretohet nëpërmjet urinës.

**Metoda:** Ne kryem një vëzhgim në 85 mostra urine të mbledhura nga gratë moshës riprodhuese të qytetit të Durrësit. Qëllimi i këtij vëzhgimi ka qenë matja e niveleve të jodit në urinën e grave të moshës riprodhuese të qytetit të Durrësit. Mostrat e urinës u grumbulluan në shishe plastike dhe u ruajtën në frigorifer deri në momentin e analizës. Përmbajtja e jodit u përcaktua me metodën kolorimetrike. Përpunimi statistikor i rezultateve është bërë me paketën statistikore MedCalc.

**Rezultate:** Sipas të dhënave të këtij vëzhgimi 32.94% e grave vuajnë nga pamjaftueshmëria e rëndë jodike, 48.23% nga pamjaftueshmëria e moderuar jodike dhe 18.82% nga pamjaftueshmëria e lehtë jodike

**Përfundime:** Të gjitha gratë të moshës riprodhuese të qytetit të Durrësit të përfshira në studim vuajnë nga deficiencia jodike.

**Fjalët kyçe:** Jod, Deficiencia jodike, Gra në moshën riprodhuese, Jodi në urine.

## REAKSIONET E PADËSHIRUARA TË BARNAVE TË LIDHURA ME BARNAT ANTITUBERKULARE TË LINJËS SË PARË

MARKIDA MARGJEKA<sup>1</sup>, AFRIM TABAKU<sup>2</sup>

<sup>1</sup> *Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti ALDENT, Tiranë, Shqipëri.*

<sup>2</sup> *Qendra Kerkimore Farmakoterapeutike, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri.*

**Hyrje:** Tuberkulozi (TB) ka qënë një sëmundje e zakonshme kronike infektive në komunitetet njerëzore. Përveç komplikacioneve të lidhura me sëmundjen, mund të ketë shfaqje të efekteve serioze të reaksioneve të padëshiruara gjatë terapisë me barna antituberkulare të linjës së parë. Qëllimi i këtij sondazhi ka qënë vlerësimi i incidencës dhe rëndesës së efekteve të padëshiruara (ADRs) të shkaktuara nga barnat antituberkulare të linjës së parë, si dhe ndërveprimet e mundshme gjatë terapise me keto preparate.

**Metoda:** Ne kemi kryer një sondazh retrospektiv nder-seksional të bazuar në analizat e të dhënave të 106 kartelave mjekësore të pacientëve të shtruar në spitalin e sëmundjeve të mushkërive. Nëpërmjet pyetesorit kemi mbledhur të dhëna mbi karakteristikat socio-demografike të pacienteve, mbi sëmundjet shoqëruese dhe barnave që janë përdorur për mjekimin e tuberkulozit. Të dhënat për reaksionet e padëshirueshme u morën nga shënimet në kartelat e pacientëve, ndërsa të dhënat për ndërveprimet e barnave u nxorën nga Medscape Drug Interaction Checker. Përpunimi statistikor i të dhënave është bërë me anë të paketës statistikore MedCalc 10.

**Rezultate:** Në 26 paciente (24.52%), nga 106 gjithesejt, u shfaqën reaksione të padëshirueshme të shkaktuara nga barnat antituberkulare të linjës së parë. Bazuar në të dhënat e sondazhit të kryer, reaksionet e padëshirueshme të barnave antituberkulare të linjës së parë u shfaqën me incidence 9.09% në pacientet femra dhe 25% në pacientët meshkuj. Sistemi organi më i prekur rezultoi ai gastrointestinal, dhe më pak të prekura ai hepatobiliar dhe muskuloskeletal. Nga ndërveprimet e barnave 52.38% rezultuan të lehta, 38.09% të mesme dhe 9.52% të rënda. Përsa i përket natyrës së ndërveprimeve, 8.57% rezultuan farmakodinamike, 61.90% farmakokinetike dhe 9.52% me natyrë të panjohur.

**Përfundime:** Barnat antituberkulare mund të shkaktojnë reaksione të padëshirueshme, disa here edhe të rënda. Pacientet e gjinisë mashkullore duhet konsideruar si grup në risk për zhvillimin e këtyre reaksioneve. Shumica e ndërveprimeve të barnave rezultuan të lehta. Përsa i përket natyrës së ndërveprimeve të barnave të përdorura nga pacientët, shumica e ndërveprimeve rezultoi farmakokinetike.

**Fjalë kyçe:** Reaksione të padëshirueshme të barnave; tuberkuloz; pacientë të shtruar në spital; rëndesa; ndërveprimet e barnave.



## KONTROLLI I DISLIPIDEMISE NEPERMJET SUPLEMENTIT USHQIMOR OKSIKOL

FATIME KALAJA<sup>1</sup>, AFRIM TABAKU<sup>2</sup>

<sup>1</sup> *Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti ALDENT, Tiranë, Shqipëri.*

<sup>2</sup> *Qendra Kerkimore Farmakoterapeutike, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri.*

**Hyrje:** Dislipidemia është një faktor presispozues patogjen për sëmundjet kardiovaskulare dhe që kontribon në zhvillimin e arteroskerozës koronare. Ka një marëdhënie të ngushtë ndërmjet uljes së niveleve të kolesterolit në gjak dhe incidencës së këtyre sëmundjeve. Vetë karakteristike e dislipidemisë është përqëndrimi i lartë të triglicerideve në plazëm, përqëndrim i HDL kolesterol i ulët dhe rritje të përqëndrimit të LDL kolesterolit. Në kohën e sotme shumellojshmëria e barnave dhe suplementesh që ulin nivelin e yndyrnave hap mundësi të reja për pacientët për të arritur nivelet e dëshiruara të yndyrnave në gjak. Nivelet e kolesterolit në organizëm mund të rriten për arsye të predispozimeve gjenetike, veprimet të radikaleve të lira, rritjes së konsumit të yndyrnave të cilësisë së dobët në dietë, rritja e stilit të jetës sedentare ose duhanpirja. Shumë pacientë shqiptarë përdorin statina për parandalimin e problemeve kardiovaskulare dhe vdekshmërinë. Megjithatë, të dhënat për efektivitetin dhe sigurinë e terapive me statina janë të pamjaftueshme.

**Metoda:** 100 persona të dy seksëve iu nënshtruan një prove klinike për 3 muaj me radhë duke marrë nga një kapsulë në ditë. Indikatorët e dislipidemisë u analizuar para se të fillohej prova klinike dhe 3 muaj pas saj. Qëllimi i këtij vëzhgimi ishte të ndricojë reduktimin e indikatorëve të dislipidemisë, si rezultat i përdorimit të suplementit ushqimor Oksikol për tre muaj me radhë.

Përpunimi statistikor i rezultateve është bërë me paketën statistikore MedCalc

**Rezultate:** Të dhënat e përfuara nga keto prova klinike treguan se pas 3 muajsh niveli i kolesterolit total u reduktua me 25.5%, nivelet e triglicerideve u reduktuan me 24.5%, niveli LDL u ul me 23.4%, dhe niveli i HDL u rrit me 21%.

**Përfundime:** Përdorimi i suplementit ushqimor Oxicol përmirësoi shumë indikatorët e dislipidemisë

**Fjalët kyçe:** dislipidemia, kolesterol, trigliceridet, LDL, HDL, Oxicol.

## INDEKSI I MASËS SË TRUPIT DHE HIPERTENSIONI

*KLEA KACORRI<sup>1</sup>, AFRIM TABAKU<sup>2</sup>*

<sup>1</sup> *Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti ALDENT, Tiranë, Shqipëri.*

<sup>2</sup> *Qendra Kërkimore Farmakoterapeutike, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri.*

**Hyrje:** Obeziteti është një sëmundje kronike shumë faktoriale, që i detyrohet një teprice yndyre në organizëm. Vitet e fundit prevalenca e obezitetit është rritur në mënyrë dramatike në shumë vende. Obeziteti është për kufizuar si një rritje e indit yndyror dhe ka lidhje me rritjen e numrit të një morie sëmundjesh kronike, si diabetus melitus, hipertension ose kancer, si dhe ka lidhje me rritjen e përqindjes së vdekshmërisë. Kështu, yndyra e organizmit, në mënyrë të vecantë, yndyra e shpërndarë në organizëm është përdorur si indikator risku për shëndetin e njeriut.

Qëllimi i këtij studimi ishte vlerësimi i marreëdhënieve ndërmjet obezitetit dhe hipertensionit në popullatën në moshë të re që jeton në qytetin e Tiranës.

**Metoda:** Ne kryem një studim ndër-seksional të bazuar në një mostër prej 120 subjektsh, gra dhe burra, duke i vlerësuar indeksin e masës së trupit (BMI), si dhe presionin sistolik dhe ate diastolik të gjakut. Përpunimi statistikor i rezultateve është bërë me paketën statistikore MedCalc 10.

**Rezultate:** Sipas rezultateve të këtij studimi 44.17% e subjekteve që u nënshtruan studimit kishin BMI në nivelet normale, 50% ishin mbi peshe dhe 5.83% ishin obeze, ndërsa pjesa e përket hipertensionit rezultatet e perftuara treguan vlerat 11.54%, 93.44% dhe 100% respektivisht mbi vlerat normale. Për të dy seksat të gjitha variablet ishin më të larta se vlerat e rekomanduara të hipertensionit.

**Përfundime:** Studimi i kryer tregoi një korrelacion ndërmjet obezitetit dhe hipertensionit në adultët e rinj të qytetit të Tiranës. Rritja e presionit sistolik dhe atij diastolik e lidhur me indeksin e obezitetit, konfirmoi faktin se është yndyra përgjegjëse për korrelacionin ndërmjet obezitetit dhe hipertensionit.

**Fjalët kyçe:** Indeksi i masës së trupit, hipertensionit, presioni i gjakut, mbipësia, obeziteti

## STUDIM I PËRDORIMIT TË ANTIBIOTIKËVE

**DORISA NEZIRI<sup>1</sup>, ISELDA KULEMANI<sup>2</sup>, KLODIOLA DHAMO<sup>3</sup>**

<sup>1,2</sup> *Departamenti i Farmacisë; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri.*

<sup>3</sup> *Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri*

**Hyrje:** Antibiotikët janë barna që ndihmojnë në ndalimin e infeksioneve të shkaktuara nga bakteret. Ato e bëjnë këtë duke vrarë bakteret ose duke i mbajtur ata të mos kopjohen vetë ose të riprodhohen. Fjala antibiotik do të thotë "kundër jetës". Çdo bar që vret bakteret është një antibiotik. Por shumica e njerëzve e përdorin termin kur flasin për barin që ka për qëllim të vrasë bakteret.

Qëllimi i këtij punimi ishte studimi i përdorimit të antibiotikëve dhe disa kriteret e përdorimit të tyre si antibiotiku më i përdorur, numri i recetave me antibiotikë, formëdozat e përdorura etj.

**Materiale dhe metoda:** Për të realizuar këtë punim u mbledhën të dhëna nga 105 receta në farmaci në qytetin Peshkopi – Dibër. Të dhënat u hodhën në tabelë duke i renditur sipas numrit rendor. U specifikua klasa e çdo antibiotiku të përmendur, u shënua numri i barnave për recetë dhe numri i antibiotikëve për recetë, si edhe formëdoza e përdorur. Të dhënat u përpunuan në microsoft excel dhe u paraqitën në tabela dhe grafikë si më poshtë vijon.

**Rezultate dhe diskutime:** Në studimin e kryer mbi 105 receta mjekësore u analizuan antibiotikët e përshkruar nga mjekët në recetat mjekësore. Vërejmë se antibiotikët më të përshkruar nga mjekët në grupin e penicilinave dhe  $\beta$ -laktamikëve janë Cefaclor dhe Ceftriaxone përkatesisht me nga 11 receta (17%) për secilin antibiotikë ndërsa antibiotikët me pak të përshkruar janë: Ampicillin, Cefazoline, Cefpodoksim me nga 1 recetë (1%).

**Përfundime:** Studimi na tregoi që përdorimi i antibiotikëve është një sjellje multifaktoriale e formuar nga faktorë demografikë, individualë (njohuri dhe qëndrim) dhe organizativ. Duhet të ketë një theks të veçantë në zbatimin e udhëzimeve dhe ligjeve gjatë përshkrimit dhe shpërndarjes së antibiotikëve.

**Fjalët kyçe:** Antibiotikë, receta, barna, diagnoza.

## USHQIMET PROBIOTIKE, VETITË USHQYESE DHE RËNDËSIA E TYRE NË ORGANIZMIN TONË

SELENA VISHA<sup>1</sup>, LORENA MEMUSHAJ<sup>2</sup>, JONA KERI<sup>3</sup>

<sup>1,2</sup> Departamenti i Farmacisë; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri.

<sup>3</sup> Qendra Kerkimore Farmakoterapeutike, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri.

**Hyrje:** Probiotikët janë mikrobe të gjalla që mund të përfshihen në një shumëllojshmëri produktesh, duke përfshirë ushqimet, barnat farmaceutikë dhe suplementet ushqimore. Probiotikët janë zakonisht specie *Lactobacillus* dhe *Bifidobacterium*, por gjithashtu përdoren edhe majaja *Saccharomyces cerevisiae*, si dhe disa lloje *E. coli* dhe *Bacillus*. Megjithatë, fjala "probiotik" duhet të përdoret vetëm për mikrobet e gjalla që janë demonstruar se kanë një përfitim shëndetësor veçanërisht në traktin intestinal.

**Materiale dhe metoda:** Për të patur një informacion sa më të detajuar mbi faktin sesa njihen efektet e probiotikëve dhe prebiotikëve në vendin tonë, është kryer një studim bazuar mbi anketimin e 130 personave të grupmohave të ndryshme. Studimi kishte si qëllim marrjen e informacionit se sa njihen efektet e dobishme të probiotikëve, por njëkohësisht dhe mënyrën sesi njeriu mund ti marrë ato, si dhe burimet kryesore të tyre.

**Rezultate dhe diskutime:** Pjesëmarrësit janë pyetur se çfarë mendojnë mbi konsistencën e probiotikëve dhe rezultoi se vetëm 56.1% e tyre mendonin se ishin mikrobe të gjalla, pjesa tjetër mendonin se ishin komponime kimike ose droga të sintetizuara. 68.5% e pjesëmarrësve konsumonin kosin si burim kryesor i marrjes së probiotikëve në një dietë ushqimore. 87.8% e të anketuarve mendojnë se mënyra më e mirë e marrjes së probiotikëve është nëpërmjet ushqimeve dhe pijeve, ndërsa pjesa tjetër janë të mendimit se suplementet ushqimore do të ishin mënyra më e mirë e marrjes së probiotikëve me qëllim marrjen e tyre në sasinë e nevojshme në momentin e duhur.

**Përfundime:** U vu re se në përgjithësi ka një informacion të pakët mbi ushqimet probiotike, kjo ka bërë që njerëzit të ngurojnë për ti marrë ato në forma farmaceutike apo nëpërmjet ushqimeve.

**Fjalët kyçe:** probiotik, prebiotik, *Lactobacillus*, *Bifidobacterium*, ushqime.

## SËMUNDJET INFEKTIVE NË QYTETIN E KORCËS DHE ROLI I SHËRBIMIT FARMACEUTIK

ANISA KANANI<sup>1</sup>, AGIM SHEHU<sup>2</sup>, INA XHANGOLI<sup>3</sup>

<sup>1,2,3</sup> *Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Aldent, Tiranë Shqipëri*

**Hyrje:** Sëmundjet infektive një problem i madh në ditët e sotme. Sëmundjet infektive janë cregullime të shkaktuara nga mikroorganizma, të cilët jetojnë në trupin e njeriut .

Këto janë zakonisht të padëmshëm por edhe të dobishëm për shëndetin, në rrethana të tjera ato shkaktojnë sëmundje ngjitëse

**Materiale dhe metoda:** Për të kuptuar se si këto sëmundje infektive përhapen kaq shpejt dhe për të analizuar përhapjen e sëmundshmëris në qytetin e Korcës , morëm në studim tre vitet e fundit numrin e vizitave apo shtrimeve në spitalin e qytetit dhe nga analizat e kryera.

**Rezultate dhe diskutime:** Kemi parë që sëmundjet infektive më të përhapura në këtë qark janë: tifo, sifilizi primar, covid 19, hepatit .Nga ky studim mosha më e prekur ka qenë 60/64 vjec dhe kryesonte gjinia mashkull.Morëm në studim protokollet e mjekimit sipas sëmundjeve,duke parë dhe bashkepunimin e shërbimit shëndetësor dhe atij farmaceutik, që ndihmuan në trajtimim e këtyre sëmundjeve .

**Përfundime:** Shifrat krahasuese të sëmundjeve ngjitëse në qytetin e Korcës rezultuan njësoj si ne të gjithë vendin, gatishmëria e shërbimit mjekësor dhe atij farmaceutik bënë që humbjet e jetëve të jenë të pakta.

**Fjalët kyce:** Sëmundje infektive , covid19,sifiliz.

---

## **B. SESIONI I SHKENCAVE DENTARE**

---

### **Abstrakte**

## SILANTET NË PARANDALIMIN E KARIESIT (RISHIKIM LITERATURE)

*MESUARA PASHO<sup>1</sup>, DANIELA KUME<sup>2</sup>*

*<sup>1,2</sup> Departamenti i Stomatologjise; Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri.*

**Hyrje:** Silantet janë veshje të holla, të përbëra nga material me bazë rezine me ngjyrë të çelët. Ato vendosen në sipërfaqet përtpese të dhëmbëve të pakariuar, kryesisht në ato të premolareve dhe molareve. Silantet janë të përshtatshëm për të gjithë fëmijët që janë të ndjeshëm ndaj kavitetëve ose për ata që e kanë të vështirë të pastrojnë dhëmbët siç duhet. Fëmijët midis moshës 6 dhe 14 vjeçare kanë më shumë gjasa të vendosin silante, veçanërisht në premolarët dhe molarët e tyre. Kjo për shkak se sipërfaqet okluzale dhe ato proksimale të këtyre dhëmbëve mund të bëhen lehtësisht shtëpi për bakteret, ushqimin dhe akumulimin e pllakave duke çuar në karies të dhëmbëve.

**Qellimi:** Te Reduktojmë rrezikun e prekjes nga kariesi sidomos tek molarët me përdorimin e silanteve. Te evidentojmë efektivitetin e përdorimit të silanteve. Te tregojmë që Silantet janë të sigurt si dhe të shpjegojmë llojet e ndryshme të tyre.

**Materiale dhe metoda:** Për materialin e këtij prezantimi janë shfrytëzuar burime të ndryshme literature, referime shkencore dhe website të ndryshme si dhe libra mjeksorë.

**Përfundime:** Suksesi që përcakton qëndrimin e silanteve në sipërfaqen përtpese varet nga kushtet klinike në kohën e përdorimit të tyre. Mënyra e nje mjedisi të thate përcakton retensionin e tyre, si dhe kohezgjatjen e qëndrimit të tyre në fisurat e premolareve dhe molareve. Vleresimi i retensionit klinik të silanteve është i domosdoshëm për parandalimin e kariesit. Në sajë të aderenës së tyre silantet luajnë rolin e një barriere fizike në kavitetin oral.

**Fjalët kyçe:** Parandalim, Silante, karies, fisura, premolare, molare

## **IMPLANTET POSTEXTRACTIVE- RASTE KLINIKE**

**ARDIAN KOZHANI<sup>1</sup>, BESNIK SHEHAJ<sup>2</sup>, ESTELA HALIMI<sup>3</sup>, ERION SHEHU<sup>4</sup>**

*<sup>1,2,3,4</sup> Departamenti i Stomatologjise; Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri.*

**Qellimi:** Te vleresoj efikasitetin dhe rezultatin klinik te vendosjes te implanteve post extractive ne regjionet posterior te mandibules dhe maxilles.

**Metoda dhe materiale:** Ne 3 raste klinike eshte aplikuar teknika e vendosjes te implanteve direkt pas ekstraksionit te dhembeve ,duke perdorur shtesa kockore dhe membrana te rezorbueshme. Pacientet jane ndjekur ne follow up npm ekzaminimit klinik dhe imazherik. Jane vleresuar kriteret si defekte ne inde te buta dhe te forta peri-implantare dhe integrimi i implanteve.

**Rezultate:** Implantet postextractive jane integruar me sukses ne periudhen kohore te vleresimit prej 6-8 muajsh .Nuk u verejten recesione te indeve te buta peri-implantare.

**Përfundime:** Bazuar ne studimet e fundit dhe ne te dhenat e limituara te rasteve klinike te mesiperme, implantet postextractive jane efikase dhe paraqesin rezultate klinike te ngjashme me implantet e vendosur pas sherimit te alveoles. Vleresimi i indikatoreve te riskut si defektet kockore, lloji i biotipit dhe pozicionimi i implanteve percaktojne suksesin e integrimin te indeve peri-implantare postextractive.

**Fjalët kyçe:** Implant, post-ekstraktiv, oseintegrim, stabilitet.



## TERAPIA ESTETIKE E DHEMBEVE TE PERHERSHEM TE ADOLESHENTET

*ERSILDA HYSA<sup>1</sup>, DIANA BROVINA<sup>2</sup>*

*<sup>1,2</sup> Departamenti i Stomatologjise; Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri.*

**Hyrje:** Terapia estetike ne dentistrine mund te ndertojne nje buzeqeshje te bukur ate qe adoleshentet dhe prindrit e tyre kerkojne . Ne ditet e sotme jo vetem ne te rriturit por edhe te femijet apo moshat me te reja, ne praktiken klinike veme re nje ose disa probleme estetike. Por ne keto moshat menyra se si e shohin veten eshte nje faktor shume i rendesishem per rritjen e tyre apo per jeten e tyre sociale dhe anen psikologjike. Nje problem qe po haset shesh sot esht agenezia, nje problem kongenital qe ka te beje me mungesen e nje ose me shume dhembeve ne kavietetin oral.

**Materialet dhe metoda:** Per realizimin e kesaj teme jemi mbeshtetur ne: Dentistrine pediarike, ne nje teajtimin estetik te kryer nga Gregory Camaleonte ne vitin 2018 dhe Style Italiano.

**Konkluzioni:** Rikthimi i buzqeshjes se adoleshenteve eshte nje faktor shume i rendesishem per adoleshentet ne aspektin social dhe psikologjik.

**Fjalët kyçe:** agenezi, buzeqeshje, trajtim.

## PERPUNIMI MEKANIK DHE KIMIK, GJATE TRAJTIMIT TE PERIODONTITEVE KRONIKE NE NJE SEANCE. RISHIKIM LITERATURE

**KAMELA BERLAT<sup>1</sup>, JORGI KUVARATI<sup>2</sup>, AGRON METO<sup>3</sup>**

<sup>1,2,3</sup> *Departamenti i Stomatologjise; Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti Aldent, Tiranë,  
Shqipëri*

**Hyrje:** Periodontitet kronike apikale janë patologji të shpeshta endodontike, që provokohen kryesisht nga kariesi i pamjekuar. Nuk përjashtohen rastet dhe të periodontiteve traumatike, paradontologjike dhe kimike. Pulpa nga vitale gradualisht nekrotizohet duke e shndërruar kanalit në një bashkësi mbeturinash amorfe dhe mikroorganizmash të panumërta. Këto të fundit, me kohë përvec sistemit kanalikular, pushtojnë dhe hapësiren periapikale. Për të rikthyer dhëmbin në normalitet, kemi aplikuar mjekimin e tij me lima dore dhe Ni-Ti të sistemit rrotator te altrënuara me shpëlarjen e kanalit me solucion Hipoklorit Natriumi 5.25% dhe përdorimin e xhelit EDTA 17%. Në këtë mënyrë është realizuar zgjerimi i mjaftueshëm i sistemit të kanalit deri te ngushtica apikale, ngushtice pozicionin e së cilës e kemi përcaktuar paraprakisht me anën e radiografisë, apex locatorit, tabeleve të gjatësisë së dhëmbëve, ndjeshmërisë dixhitale etj. Mjekimi në këtë kanal të zgjeruar mjaftueshëm, të pastruar dhe të dezinfektuar në këtë mënyrë krijohen kushte, për përfundimin e tij me një seancë, duke i lënë vendin mbushjes me kondensim lateral. Rezultatet afatshkurtra dhe afatgjata janë, impresionuese dhe po ekspozojmë një numër të konsiderueshëm radiografish para mjekimit dhe pas sherimit.

**Materiale dhe metoda:** Janë marrë 64 raste në mjekim dhe do të ekspozohen 20 prej tyre. Në teknikën e mjekimit dominon zgjerimi i kanalit me instrumenta rrotarorë Ni-Ti sipas variantit hibrid midis step back dhe crown down e cila quhet metoda standarte. Radiografite, vendosja e diagnozës, përgatitja e kavitetit, matja e gjatësisë së punës, zgjerimi dhe përpunimi i kanalit. Numri i rasteve të dhëmbëve me periodontit kronik të marë në mjekim.

**Rezultate dhe diskutime:** Mjekimi me një seancë ka sukses 80-85%.

**Përfundime:** Suksesi i mjekimit justifikon mjekimin me një seancë.

**Fjalët kyçe:** Periodontitet kronike, Hipokloriti i Natriumit, Ngushtica apikale, Instrumentat rrotarorë Ni-Ti, Mjekimi me një seancë.

## DIABETI DHE NDIKIMI I TIJ NË SËMUNDJET PERIODONTALE

*ELMA DERVISHHASANI<sup>1</sup>, EMARA NARAZANI<sup>2</sup>, ALESSIA ÇYRBJA<sup>3</sup>,  
ORGES SIMEON<sup>4</sup>*

*<sup>1,2,3,4</sup> Departamenti i Stomatologjise; Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti Aldent, Tiranë,  
Shqipëri.*

Periodonti është një strukturë komplekse që përbëhet nga katër komponentë: gingiva, cementi, ligamenti periodontal dhe kocka alveolare. Funkcionet e periodontit përfshijnë mbeshtetjen e dhëmbit në kockë, krijimin e një barriere mbrojtëse për dhëmbin nga mikroflora orale duke bere te mundur lidhjen e dhëmbit me kocken. Sëmundjet periodontale janë rezultat i infeksionit dhe inflamacionit të gingivave dhe kockës që rrethon dhëmbin. Fazat e sëmundjeve periodontale i kemi të ndara në dy grupe kryesore: gingiviti që përfshin inflamacion të gingivave dhe periodontiti, ku kemi dëmtim të fibrave periodontale, humbje të atashmentit, humbje të kockes alveolare rreth dhëmbit. Diabeti është një çrregullim ku trupi, më saktësisht pankreasi, nuk prodhon mjaftueshëm insulinë ose nuk i përgjigjet normalisht asaj, duke çuar në rritje anormale të nivelit të glukozës në gjak.

**Qëllimi:** Të kuptojmë marrëdhënien e ndërsjelltë ndërmjet diabetit dhe sëmundjeve periodontale dhe të orientojmë pacientët për mënyrat e trajtimit të sëmundjes periodontale dhe të mirëmbajtjes së higjienës orale.

**Metoda dhe materiale:** Për realizimin e temës tonë u bazuam në librin “Practical Periodontics” (Kenneth Eaton), “Clinical Periodontology” (Carranza).

**Rezultate:** Studimet tregojnë se diabeti ndikon negativisht në periodontit me anë të disa mënyrave, ku përmendim:

1. Diabeti shkakton ndryshime në enët e gjakut. Trashja e mureve të tyre mund të reduktojë kalimin e nutrientëve dhe largimin e lëndëve të panevojshme nga indet e trupit. Ky qarkullim gjaku i reduktuar dobëson gingivat dhe kockën.
2. Diabeti që nuk është nën kontroll çon në rritje të glukozës edhe në fluidin oral, që shkakton rritjen e numrit të baktereve shkaktare të gingiviteve dhe periodontiteve.
3. Diabeti ul sintezën e kolagenit, i cili është një faktor shumë i rëndësishëm në shërimin e plagëve. Prodhimi më i pakët i tij vështirëson shërimin e plagëve të ndryshme në gojë.

**Përfundime:** Duhet t’i kushtojmë shumë rëndësi një rasti të tillë ku kemi kombinim të këtyre dy sëmundjeve duke i orientuar ato në mënyrë korrekte për metodat e mjekimit si lokal ashtu edhe të përgjithshëm duke mos harruar që t’i udhëzojmë si të mbajnë një higjienë sa më të mirë personale.

**Fjalët kyçe:** periodont, periodontit, diabet, higjiene orale, etj

## NDIKIMI I DIFENILHIDANTOINËS NË HIPERPLAZINË GINGIVARE

*DENISA MUSAJ<sup>1</sup>, FABIONA PEKA<sup>2</sup>, ORGES SIMEON<sup>3</sup>*

*<sup>1,2,3</sup> Departamenti i Stomatologjise; Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri*

**Hyrje:** Difenilhidantoina është një medikament që përdoret kryesisht në trajtimin e sëmundjes së epilepsisë dhe aritmisë. Përdorimi afatgjatë shoqërohet me një numër të madh efektesh të padëshiruara, si: osteomalacia, skizat labiale dhe hiperplazia gingivare që ka dhe prevalencën më të lartë. Hiperplazia gingivare është një proces që konsiston në rritjen e tepërt të indit gingivar përreth dhëmbit, e cila shoqërohet me edemë dhe hemorragji gingivare. Agresiviteti I sëmundjes varion nga një pacient në tjetrin në varësi dhe të dozës dhe kohëzgjatjes së trajtimit me difenilhidantoinë.

**Qëllimi:** Të evidentohet lidhja që ekziston ndërmjet përdorimit të difenilhidantoinës te pacientët që vuajnë nga epilepsia dhe hiperplazisë gingivare duke u mbështetur në një rishikim literature të viteve të fundit.

**Materiale dhe metoda:** Për rishikimin e literaturës janë shfrytëzuar burime si: artikuj shkencorë bashkëkohorë, revista stomatologjike, libra të ndryshëm, ëbsite si PubMed, Cochrane Library, Medline.

**Rezultate:** Edhe pse me risk tepër të lartë për të zhvilluar hiperplazi gingivare, pacientët epileptike e kanë të nevojshme trajtimin me difenilhidantoinë. Kështu që këta pacientë duhet të bëjnë kontrolle më të shpeshta te mjeku stomatolog dhe të kenë një higjienë maksimale, në mënyrë që hiperplazia gingivare të jetë në nivele sa më të ulura.

**Përfundime:** Pacientët që përdorin difenilhidantoinë janë më të predispozuar për hiperplazi gingivare, aq më tepër kur kohëzgjatja e trajtimit dhe doza e medikamentit janë në vlera të larta. Gjithashtu duhet bërë një vlerësim I plotë periodontal për të gjithë pacientët që do të mjekohen me difenilhidantoinë, dhe nëse është e pranishme ndonjë sëmundje periodontale duhet të trajtohet në mënyrë të përshtatshme. Një trajtim rigoroz dhe adekuat sjell efekte pozitive në periodont tek pacientët epileptikë që trajtohen me difenilhidantoinë.

**Fjalët kyçe:** sëmundje periodontale, epilepsi, hiperplazi gingivare, antiepileptik, inflamacion, difenilhidantoinë.

## INFLUENCA E CEMENTEVE REZINOZE NË NGJYRËN PËRFUNDIMTARE TË FASETAVE

ALBA KAMBERI<sup>1</sup>, BRUNILDA KOÇI<sup>2</sup>

<sup>1,2</sup> *Departamenti i Stomatologjise; Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri.*

**Hyrje :** Fasetat e porcelanit janë konsideruar për një kohë të gjatë si restaurime që përdoren vetëm për qëllime estetike, por në vitet e fundit indikacionet e tyre janë rritur së tepërmi edhe në funksion të rikthimit të biomekanikës.

Qëllimi i këtij studimi in vitro është të vlerësojë efektin e tre llojeve të ndryshme të cementeve rezinoze në ngjyrën përfundimtare të fasetave.

**Materialet dhe Metodrat:** Pas miratimit nga Komiteti Etik i Fakultetit ekstraktohen dy incizivë centralë në nofullën e sipërme dhe një inciziv central në nofullën e poshtme për arsye paradontale. Dhëmbët

e ekstraktuar janë përgatitur për t'u vendosur tre fasetat IPS -max Press, ngjyra A2. Përsa i përket matjeve të ngjyrës, janë realizuar me spektrofotometër (Vita Easyshade compact). U përdorën tre cimente, dy nga të cilat ishin dual- cure dhe një light - cure. Cementet e përdorura janë Permashade LC A<sub>2</sub>, Variolink Esthetic DC, OliCem DC. Mostrat (fasetat) e marra për studim u cementuan në sipërfaqet e modeleve (dhëmbëve), të cilat janë preparuar sipas udhëzimeve të firmës prodhuese. Ngjyrat e fasetave u matën përsëri pas cementimit.

Të dhënat u përpunuan nga ana statistikore me anë të testit ANOVA.

**Rezultati:** Duke u nisur nga matjet e kryera të parametrave të ngjyrës së fasetave u matën dhe u konstatua rritje të vlerave Cab(\*) pas cementimit me cementet rezinoze.

### **Konkluzioni:**

Cementet rezinoze mund të ndikojnë në ngjyrën finale të fasetave IPS e.max Press.

**Fjalët kyçe:** IPS.e.max Press , fasetë, cement rezinoz, ngjyrë, spektrofotometër

---

## **C. SESIONI I INFERMIERISË DHE FIZIOTERAPISË**

---

### **Abstrakte**

## ROLI I INFERMIERIT NE ANESTEZI

*EMILJANO XHEDIKU<sup>1</sup>, ARBEN NDERU<sup>2</sup>, REZARTA TOTA<sup>3</sup>*

*<sup>1,2,3</sup> Departamenti i Infermierise dhe Fizioterapisë; Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike,  
Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri.*

**Hyrje:** Anestezia është fusha më agresive e mjekësisë që kryesisht merret me narkozën, vënien në gjumë të organizmit (ajo merr vetëdijen, frymëmarrjen dhe lëvizshmërinë) me anë të lëndëve narkotike për kryerjen e ndërhyrjeve kirurgjike; një organizëm të pavarur biologjik e shndërron në organizëm të varur nga ndihma e tjetrit. Fjala anestezia, do të thotë humbje e ndjenjës, gjatë së cilës mund të nënkuptohet vetëm humbja e ndjenjës së dhimbjes, humbja e vetëdijes, apo të dyja së bashku.

**Materiale dhe metoda:** Ky studim bazohet në të dhënat e mbledhura nga një pyetësor i krijuar në surveymoneky i cili u shpërnda te 17 anestezistë nga "Spitali Amerikan 1, Spitali Amerikan 2, Spitali Amerikan 3, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" dhe Spitali Ushtarak".

**Rezultate dhe diskutime:** Pavarësisht rezultateve të pyetsorit, krahasimet me vënde të tjera dhe njohurit e kërkuara flasin për evidence për krijimin e një standarti minimal.

**Përfundime:** Në Shqipëri ekziston një master profesional kirurgjikal, master shkencor në infermieri klinike dhe infermieri në kushtet e shtëpisë shtëpi. Për më tepër, sipas rezultateteve të pyetësorit anestezisti ndihmohet nga specializantët e anestezisë, kolegët e tij, infermier të trajnuar për anestezia dhe kryesisht bën atë punë, por shpeshherë edhe nga infermierët që janë të lirë në atë moment! Në këto kushte vështirësia për gjetjen e medikamenteve apo pajisjeve të caktuara për raset urgjente apo komplikacione rritet. Po ashtu edhe niveli i stresit duhet të jetë sigurisht shumë i lartë pasi nuk ka asnjë profesionist të profilizuar që është i shkolluar në medikamente dhe aparaturat e përdorura në anestezia. Prandaj në rastet urgjente kur koha është shumë e kufizuar rezultatet me një dozim më të lartë se norma e caktuar ose humbje kohën në përpjekje për të gjetur aparaturat e nevojshme nga persona jo profesionist mund të rezultojnë edhe në humbje jete.

**Fjalët kyçe :** Infermier i anestezise, Reaminator, Anestezia.

## **ROLI INFERMIERIT TE RI NE REANIMACION, PERQASIA E MIRE ME PROCEDURAT DHE PROTOKOLLET**

***DRITA FERHATI<sup>1</sup>, POMONA TINAJ<sup>2</sup>, JASINA DULLA<sup>3</sup>, IRINI SHTERPI<sup>4</sup>, PAOLA LYBESHAI<sup>5</sup>, VIRXHINIA LIKA<sup>6</sup>, REZARTA TOTA<sup>7</sup>.***

*<sup>1,2,3,4,5,6,7</sup> Departamenti i Infermierise dhe Fizioterapise, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri.*

**Hyrje:** Njësia e Kujdesit Intensiv (ICU) ë shtë një departament i vecantë që ofron kujdes intensiv për r pacient në gjendje kritike. I pajisur me personel mjekesor dhe infermier të trajnuar specifikisht, po ashtu ka pajisje që mundë sojne monitrim të vazhdueshem, në dinamike të pacientit.

**Materiale dhe Metoda:** Metodologjia e ketij studimi bazohet në ate cka kemi parë ne si student të infermierise në ICU dhe me anë të pyetesorit të kryer me student të fushes së infermierisë së pergjithshme.

**Rezultate dhe diskutime:** Nga pyetësori dhe nga vëzhgimet tona gjate praktikave ne spital, kemi dale ne rezultatet, që infermieret e rinj nuk janë në gjendje të punojne në ICU. Prej të cilëve 80% e tyre nuk janë ne gjendje të perballojne punen në ICU dhe vetem 20% e tyre ndihen te gatshem të jenë pjesë e ketij stafi.

**Perfundimet:** Nga rezultatet e nxjerra, si perfundim duhet qe te ngrihen metoda te reja arsimore ne pergatitjen e studenteve në stade më të larta për ta ofruar ketë sherbim, po ashtu dhe ofrimi i praktikave në shumë në këtë departament (ICU) për te perballuar punen dhe të qenurit të gatshem të punojne në një departament të vecantë sic është ICU.

**Fjalët kyçe:** ICU/Reanimacion, kujdes infermieror, procedura infermierore, asistence mjekesore.



## PIKËZIMI ACE DHE PROBABILITETI I SHFAQJES SË SËMUNDJEVE KARDIOVASKULARE

**ERMINA YMERAJ<sup>1</sup>, KLAJDI FIDA<sup>2</sup>, GEISI BELISHTA<sup>3</sup>, GERALDA MARKU<sup>4</sup>, ERVIN  
RESULI<sup>5</sup>, KLEDISA Tafa<sup>6</sup>**

*<sup>1,2,3,4,5,6</sup> Departamenti i Infermierise dhe Fizioterapise, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike,  
Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri.*

**Hyrje:** Traumat psikoemocionale të fëmijërisë kanë një impakt tepër të rëndësishëm në formimin e personalitetit të një individi, por jo vetëm. Sipas studimeve është vërtetuar një korrelacion ndërmjet traumave psikoemocionale të përjetuara gjatë fëmijërisë me shfaqjen e sëmundjeve kronike. Sipas studimeve, një pjesë e madhe e pacientëve të cilët vuajnë nga sëmundje kronike kanë kaluar në të shkuarën një fenomen psikoemocional traumatik. Duke qenë se në pellgun e Mesdheut, por jo vetëm, prej sëmundjeve më karakteristike që prek në masë popullsinë, pra që shprehet me një incidencë dhe prevalencë tepër të lartë janë sëmundjet kardiovaskulare. Ekzistenca e një faktori pathoetiologjik të tillë si trauma psikoemocionale përsa i përket sëmundjeve kardiovaskulare do të conte në krijimin e rekomandimeve tepër të domosdoshme në uljen e incidencës së këtij grup patologjie

**Materiale dhe Metoda:** Ky është një studim cross-sectional. Në mënyrë rastërore janë përzgjedhur një grup studentësh të cilët ndjekin studimet në Universitetin Aldent dhe një grup pacientesh kardiak që marrin trajtim mjekësor në QSUNT me qëllim evdntimin e stresorëve psikoemocional në të kaluarën dhe më pas probabilitetin e ndikimit të këtyre stresorëve në shëndetin kardiovaskular.. Të dhënat janë mbledhur duke u kryer pikëzimi ACE dhe më pas janë përpiluar ne SPSS.

**Rezultate:** Sipas të dhënave të mbledhura dhe pas korrelimit në SPSS do të vërtetohet një lidhje statistikisht e logjikshme ndërmjet stresit psikoemocional në fëmijëri dhe shfaqjes së sëmundjeve kardiovaskulare. Ky ndikim ndoshta do t'i atribuohet formëzimit të një personaliteti të mbyllur dhe jo të shëndoshë, gjë që sjell një mënyrë jetese jo të shëndetshme dhe tepër stresante. E gjitha kjo, ndikon negativisht në shëndetin kardiovaskular.

**Përfundime:** -Sa më i lartë ACE-Score aq më shumë rritet probabiliteti për shfaqjen e sëmundjeve kardiovaskulare.

**Fjalët kyçe:** Shëndet kardiovaskular, Trauma, Stresi.

## INCIDENCA DHE PREVALENCA E KANCERIT KOLONO-REKTAL NË SHQIPËRI. FAKTORËT PRECIPITUES

**ARBINA BEZHANI<sup>1</sup>; GEISI BELISHTA<sup>2</sup>; ENGJËLL HOXHALLI<sup>3</sup>; ESMERALDA  
CAPARO<sup>4</sup>; KLEVISTA SEFA<sup>5</sup>; PAOLA ZITI<sup>6</sup>**

*<sup>1,2,3,4,5,6</sup> Departamenti i Infermierise dhe Fizioterapise, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike,  
Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri.*

**Hyrje:** Kohët e fundit, incidenca e shfaqjes së sëmundjeve onkologjike që prekin traktin gastrointestinal, specifikisht kolonin dhe rectumin është rritur ndjeshëm. Sipas ISHP, në Shqipëri për vitin 2018 numërohen rreth 213 vdekje si pasojë e kancerit kolonorektal, por kjo shifër vazhdon ende të jetë në rritje. Kanceri kolonorektal prek në masë grupmoshat mbi 50 vjec, dhe është një ndër tumoret më vdekjeprurës tek meshkujt pas kancerit pulmonar. Ekzistojnë një sërë faktorësh të njohur etiologjik të cilët diskutohen pak ose aspak dhe që nuk merren parasysh si metoda parandaluese të shfaqjes së kancerit. Vlerësimi dhe evidentimi i këtyre faktorëve precipitues është një hap kyc në parandalimin e sëmundjeve tumorale që prekin colonin dhe rectumin, dhe këta faktorë duhen marrë patjetër parasysh gjatë kryerjes së metodave depistuese.

**Materiale dhe Metoda:** Janë anketuar një grup pacientësh të cilët vuajnë nga kanceri kolonorektal dhe marrin trajtim në QSUNT me qëllim evidentimin e faktorëve precipitues të shfaqjes së kancerit. Të gjitha të dhënat e mbledhura u përpiluan në programin statistikor SPSS.

**Rezultate:** Sipas të dhënave të mbledhura, dhe pas kryerjes së korrelacionit në SPSS, rezulton se një sërë faktorësh të tillë si: mënyra e jetesës, sëmundjet bashkëshoqëruese, hereditariteti etj ndikojnë në shfaqjen e sëmundjeve tumorale kolonorektale. Këta faktorë identifikohen pak ose aspak nga mjekët trajtues dhe asnjë program edukimi shëndetësor nuk ekziston në mënyrë që të parandalohet në kohë shfaqja e sëmundjeve tumorale të traktit gastrointestinal.

**Përfundime:** Identifikimi në kohë i faktorëve precipitues së kancerit kolonorektal parandalon shfaqjen e sëmundjes, rritjen e incidencës dhe ul mortalitetin.

**Fjalë kyce:** Shëndeti gastrointestinal, Sëmundjet tumorale, Incidencë, Faktorë precipitues.

## MENAXHIMI INFERMIEROR I SITUATAVE AGRESIVE NË PSIKIATRI

**MIRELA TUSHE<sup>1</sup>**

<sup>1</sup> *Departamenti i Infermierise dhe Fizioterapise, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike,  
Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri.*

**Hyrje:** Për te menaxhuar pacientin e axhituar infermierja duhet të respektojë protokollin e kujdesit. Infermierët në rradhë të parë garantojnë sigurinë e pacientit, të pacientëve të tjerë dhe të vetes së tyre. Ata ndërmarrin një sërë masash duke mos lejuar përshkallëzimin e agresionit, largojnë mjetet e rrezikshme, kufizojnë pacientin nëse do të jetë e nevojshme, përdorin mjekime për kontrollin e violencës, kryejnë një monitorim të vazhdueshëm. Gjatë menaxhimit të pacientit të axhituar duhet marrë në konsideratë rreziku i shfaqjes së efekteve anësore të barnave që po administrohen tek pacienti i axhituar. Bashkëpunimi me mjekët specialistë dhe psikoterapia është e domosdoshme. Edukimi shëndetësor është një aspekt i rëndësishëm.

**Materiale dhe Metoda:** Shqyrtim i literaturës dhe eksperiencës klinike mbi protokollin e sigurisë përsa i përket kujdesjeve infermiere që kryhen në pacientët me crregullime të shëndetit mendor dhe nxjerrja e rekomandimeve të nevojshme mbi masat e sigurisë që duhen ndërmarrë për ruajtjen e pacientëve dhe stafit infermieror.

**Rezultate:** vlerësimi paraprak i pacientit përpara kryerjes së ndërhyrjeve infermiere është një hap tejet i rëndësishëm në parandalimin e incidenteve apo shpërthimeve të agresivitetit në pacientët me crregullime psikiatrike. Sa më mirë të merret anamneza e sëmundjes, sa më butësisht të paraqitemi tek pacienti aq më shumë ulet rreziku për shfaqjen e sjelljeve tipike agresive. Një vlerësim në retrospektivë i preparateve psikofarmakologjike që përdoren në pacientët tanë dhe rregullimi apo sistematizimi i dozës gjithashtu do të ndikojë pozitivisht në uljen e fenomeneve agresive. Edukimi shëndetësor i prindit apo kujdestarit por gjithashtu edhe i vetë pacientit (kur situatë e lejohet) ndikon pozitivisht në evitimin e sjelljeve agresive.

**Përfundime:** - Psikoterapia është e vetmja metodë e provuar shkencërisht me anë të së cilës parandalohen sjelljet agresive apo axhitimi i pacientëve.

-Paraqitja sa më ëmbël tek pacienti dhe kryerja sa më pak e veprimeve që ngjallin dyshime tek ai ndikon pozitivisht në qetësimin e pacientit të axhituar.

**Fjalët kyçe:** Psikoterapi, Axhitim, Agresion, Sjellje, Kujdesje Infermiere

## TROMBOZA E MEZENTERIT. SHKAQET E RRIJTJES SË INCIDENCËS NË SHQIPËRI

*GEISI BELISHTA<sup>1</sup>*

<sup>1</sup> *Departamenti i Infermierise dhe Fizioterapise, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike,  
Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri.*

**Hyrje:** Tromboza e mezenterit është një sëmundje debilituese e cila afekton shëndetin gastrointestinal dhe në shumicën e rasteve është e papajtueshme me jetën. Trajtimi konsiston në intervenimin kirurgjikal urgjent në mënyrë që të ruhet funksioni dhe perfuzioni I organeve të afektuara (shpesh stomaku, zorra e hollë, mezenteri dhe organet perreth). Kohet e fundit, në Reanimacionin Kirurgjikal në QSUNT është vënë re një rritje e incidencës dhe mortalitetit si pasojë e kësaj sëmundjeje. Faktorët precipitues ende nuk janë evidentuar, dhe asnjë masë parandaluese nuk ekziston në mënyrë që të evitohet ky komplikacion I rëndë I hemodinamikës së traktit gastrointestinal

**Materiale dhe Metoda:** Janë shqyrtuar rastet që janë paraqitur me këtë diagnozë në Reanimacionin Kirurgjikal dhe është tentuar të gjendet një korrelacion ndërmjet këtij komplikacioni dhe infektimit me SARS-CoV -2 në te shkuarën në mënyrë që kjo diagnozë të konsiderohet si një komplikacion long-term I infektimit me SARS-CoV-2. Të gjitha të dhënat e mbledhura janë përpiluar në SPSS.

**Rezultate:** Për shkak se mbledhja të dhënave ka qenë tepër e vështirë sepse kjo diagnozë shpesh është e papajtueshme me jetën, arritja në rezultate fikse ende nuk është e mundur. Rezultatet paraprake tregojnë se ekziston një lidhje ndërmjet kalimit rëndë të infektimit me SARS-CoV-2 me shfaqjen në të ardhmen të trombozës së mezenterit

**Përfundime:** -Tromboza e mezenterit mund të jetë një komplikacion long term I SARS-CoV-2. Ky fakt duhet shqyrtuar dhe studiuar më tepër në mënyrë që të krijohen rekomandime konkrete në parandalimin e shfaqjes së këtij komplikacioni apo një terapi adekuate me antikoagulantë gjatë ose pas kalimit të infeksionit vjrtal.

**Fjalët kyçe:** SARS-CoV-2, Trombozë Mezenteri, Komplikacion long-term, Terapi me antikoagulantë.

## RËNDËSIA E REHABILITIMIT FIZIOTERAPEUTIK NË PACIENTËT ME EPIKONDILITIS (EPIKONDILITIS LATERAL)

*ELONA LACI<sup>1</sup>, XHEJNI KURTI<sup>2</sup>*

*<sup>1,2</sup> Departamenti i Infermierise dhe Fizioterapise, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri.*

**Hyrje:** Epikondilitet janë struktura anatomike të cilat lokalizohen vetëm në artikulationin cubiti. Epikondilitis është inflamacion i epikondilit. Epikondilitis lateral ndryshe quhet bërryli i tenistit. Kjo patologji manifestohet tek pacienti me dhimbje dhe pamundësi për të mobilizuar artikulationin. Objektivi i studimit është identifikimi i rëndësisë së rehabilitimit fizioterapeutik në rifitim të funksionalitetit të artikulationit cubiti tek pacientët me epikondilitis lateralis. Qëllimi i studimit është identifikimi i rehabilitimit fizioterapeutik në pacientët me bërrylin e tenistit.

**Materiale dhe metoda:** U përzgjedh një paciente e diagnostikuar me epikondilitis lateralis. Tek pacientja u aplikua një protokoll i detajuar fizioterapeutik. U maten parametrat para dhe pas trajtimit. U analizuan rezultatet duke përdorur shkallën subjektive të vlerësimit të dhimbjes VAS (Visual Analogue Scale). Kjo shkallë lineare është përfaqësimi vizual i madhësisë së dhimbjes që një pacient mendon se po përjeton.

**Rezultate dhe diskutime:** U pa se pacientja e marrë në studim pas aplikimit të protokollit fizioterapeutik pati përmirësime në uljen e dhimbjes si dhe në përmirësimin e funksioneve të jetës së përditshme. Gjithashtu dhe gjendja psikologjike e pacientes pati progres.

**Përfundime:** Protokollin fizioterapeutik i aplikuar rezultoi i suksesshëm tek pacientët me epikondilitis lateralis.

**Fjalët kyçe:** epikondilitis, artikulationi cubiti, rehabilitimi fizioterapeutik, dhimbje.

## **EFIKASITETI I MOBILIZIMIT TORAKAL (LEWI MOBILISATION) NË PACIENTËT POST COVID-19**

**ANXHELA HALLUNAJ<sup>1</sup>, ROXHENSA SULA<sup>2</sup>**

<sup>1,2</sup> *Departamenti i Infermierise dhe Fizioterapise, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike,  
Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri.*

**Hyrje:** Covid-19, pandemia e vitete '19-'22 solli shumë humbje jete dhe shumë defiçite neuro-motorike në popullatë. Studimi ynë do të përqëndrohet në analizimin e rolit apo efikasitetin e mobilizimeve të Lewit në rritjen e mobilitetit torakal tek pacientët post Covid-19.

**Materiale dhe metoda:** Për të kuptuar sesa efikase mund të jenë mobilizimit e Lewit në pacientët post Covid-19, u përzgjedh një pacient i cili i ka qenë i intubuar për 2 muaj. Kriteret e përzgjedhjes së pacientit ishin:

1. Pacienti duhet të ishte post Covid-19
2. Nuk duhet të kishte kaluar më shumë se 1 muaj nga negativizimi i pacientit

Përpos fizioterapisë respiratore u përdorën dhe mobilizimet e Lewit në regjionin torakal me qëllimin për të analizuar efektshmërisë ose jo në rritjen e mobilitetit torakal dhe në rritjen e kapacitetit respirator. Pacienti u ndoq në dinamikë për 10 seanca.

**Rezultate dhe diskutime:** Bazuar tek rezultatet u pa se mobilizimet e Lewit rezultuan efikase në rritjen e kapacitetit pulmonar në 93% të saj, në reduktimin e frymëshkëmbimeve/minut si dhe në përmirësimin e mobilitetit torakal fiziologjik pa dhimbje.

**Përfundime:** U vu re se mobilizimit e Lewit nuk arritën 100% kapacitetin pulmonar, kjo sipas matjes spirometrike, sepse kërkohet një kohë më e gjatë rehabilitimi.

**Fjalët kyçe:** Toraks, frymëshkëmbim, mobilizimet e Lewit.



---

## **D. SESIONI I TEKNIKË LABORATORI MJEKËSOR DHE IMAZHERI**

---

**Abstrakte**

## **MATJA E VITAMINËS D NË ADULTË.ROLI DHE PASOJAT E DEFICËNSËS NË ORGANIZËM.**

**MIGENA GJONI<sup>1</sup>, MARIA DHIMERTIKA<sup>2</sup>, MIGENA NABOLLI<sup>3</sup>,**

**SELIME DERVISHI<sup>4</sup>, SINDI AGOLLI<sup>5</sup>, ALBINA HASA<sup>6</sup>**

*<sup>1,2,3,4,5,6</sup> Departamenti i Teknikë Laboratori Mjekësor dhe Imazheri; Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike; Universiteti Aldent, Tiranë, Albania.*

**Hyrje:** Vitamina D është esenciale në mirëmbajtjen e një gjendje të mirë shendetësore. Burimet e kësaj vitamine mund të jenë nga marrja me dietën dhe sintetizimi përmes lëkurës. Vlerësimi i vlerave të kësaj vitamine është esenciale në shëndetin e njeriut pasi deficiencia e saj con në morbiditete të ndryshme si; patologjikockore, kardiake, neurologjike, endokrine apo kancer. Synimi ynë është vlerësimi i kësaj vitamine tek adultë të moshave të ndryshme, veçanërisht në studentë.

**Materiale dhe Metoda:** Një studim random rast-kontroll me një kontigjent prej 70 subjektsh të marrë pranë universitetit Aldent. Subjektet u informuan dhe ranë dakord të jenë pjesë e studimit. Mostrat laboratorike u morën përmes procedurës së venopunkturës .Përmes centrifugimit të mostrës u përftua serumi dhe matja e vitaminës D në serum u realizua përmes Ichrome II. U realizua matje kuantitative dhe analizë statistikore përmes programit SPSS.

**Rezultate:** Ne subjektet e marre ne studim 84.1% ishin femra dhe 15.9% meshkuj. Nga keto 91.3% subjekte rezultuan me insuficence të vitaminës D dhe 8.7% me deficence. U konstatua mungesë informacioni mbi rolin që ka në organizmin e njeriut si edhe matje laboratorike e rrallë e kësaj vitamine nga subjektet në studim.

**Përfundime:** Dieta e varfër me vitaminë D, ekspozimi jo i mjaftueshëm ndaj rrezeve të diellit si edhe neglizhenca e matjes së vazhdueshme të nivelit të vitaminës, kanë rezultuar në identifikimin e vonë të niveleve të ulura të vitaminës D dhe si rrjedhojë vërehet deficiensë.

**Fjalët kyçe:** vitamina D, deficiensë, adultë, analiza.



## VEPRIMI BAKTERICID DHE EFEKTIVITETI I PRODUKTEVE ANTIBAKTERIALE

**KRISTINA SALIAJ<sup>1</sup>, PAULA MUHA,<sup>2</sup> ALBINA HASA <sup>3</sup> BARDHYL HAJDARAJ<sup>4</sup>**

*<sup>1,2,3,4</sup> Departamenti i Teknikë Laboratori Mjekësor dhe Imazheri; Fakulteti i Shkencave  
Mjekësore Teknike; Universiteti Aldent , Tiranë, Albania.*

**Hyrje:** Alkooli etilik, dezinfektanetet ne forme xheli dhe letrat e lagura rekomandohen zakonisht per dezinfektimin e duarve dhe ambjenteve te ndryshme. Supozohet qe ata kane nje veprim baktericid mbi 99% dhe si pasoje nje efikasitet te larte. Ditet e sotme te 3 keta element njihen dhe kane nje perdorim te gjere. Synimi I ketij studimi eshte krahasimi I efektivitetit te alkoolit etilik 96°,dezinfektantit te xhelit dhe letrave te lagura mbi patogjenet bacterial si Escherichia coli dhe Stafilokoku aureus.

**Materiale dhe metoda:** Eshte bere vleresim dhe krahasim i efektit bakericid te alkoolit etilik, xhelit dezinfektant dhe letrave te lagura mbi mikroorganizmat : Stafilokok aureus (ATCC6538) dhe Escherichia coli (AzAcc ) duke performuar antibiogramen. Mbjellje ne bujon e nje mostre kontakti te marre para dhe pas pastrimit te nje objekti me letra te lagura. Mostrat e marra jane inkubuar ne termostat ne temperaturen 37°C per 24 ore . Pas 24 oresh suspensioni I formuar eshte inokuluar ne terren agar gjak dhe macConkey.

**Rezultate dhe diskutime:** Nga të dhënat rezultoi; në rastin e Stafilokokut aureus një efekt më i madh baktericid u pa nga letrat e lagura dhe një efekt më i vogël, afërsisht i njëjti u verejt nga xheli dezinfektues dhe alkooli. Në rastin e Escherichia coli alkooli etilik rezultoi ne nje efektivitet te larte baktericidal, ndërsa xheli dezinfektues dhe letrat e lagura treguan një efekt të ulët baktericid.

**Përfundime:** Efektiviteti i produkteve antibakteriale ndikohet nga disa faktorë si; lloji i baktereve, sasia e dezinfektantit ose kushtet në të cilat përdoret.

**Fjalët kyçe:** antibiograma, efekti baktericidal, stafilokoku aureus, e.coli

## EVOLIMI I RADIOTERAPISË

**KLODIAN ÇELMETA<sup>1</sup>, OLIANA MUÇA<sup>2</sup>, EMELI MET'HOXHA<sup>3</sup>, ESTER OSHAFI<sup>4</sup>**

*<sup>1,2,3,4</sup> Departamenti i Teknikë Laboratori Mjekësor dhe Imazheri, Fakulteti i Shkencave Mjekësore  
Teknike, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri.*

**Hyrje:** Radioterapia, e njohur edhe si terapia me rrezatim, është një modalitet i zakonshëm i trajtimit onkologjik që përdor rrezatimin jonizues për të kontrolluar ose eliminuar qelizat malinje (dhe jo vetëm). Radioterapia luan një rol parësor në trajtimin kurativ, terapinë ndihmëse dhe zbutjen e simptomave të kancerit. Radioterapia mund të përdoret vetëm, ose bashkë me kimioterapinë ose imunoterapinë.

Makineritë e radioterapisë që përdoren aktualisht në praktikat klinike janë rezultat i evolucionit për një periudhë të gjatë kohore. Fusha të ndryshme të shkencës, si fizika mjekësore, inxhinieria mekanike dhe inxhinieria kompjuterike, kanë kontribuar në zhvillimin e vazhdueshëm të teknologjisë. Fusha e rishikimit ishte e kufizuar në: prodhimin e energjisë dhe zhvillimi funksional, për shkak të kufizimeve të hapësirës. E para përfshin kalimin nga teknikat fillestare të aplikuara në modelin e pare, në teknologjinë më të fundit që është aktualisht në përdorim në një shumëllojshmëri makinerish. Këto të fundit kanë pasur një efekt të drejtpërdrejtë në rezultatet e trajtimit dhe sigurinë e terapisë me rrezatim. Këto zhvillime ndryshuan modelin e terapisë me rrezatim, duke çuar në udhëzime të reja për përlogaritjen e dozës, inovacionin e mjeteve të verifikimit të dozës, metodat e reja të matjes dhe sistemet e llogaritjes për dozat e rrezatimit, kriteret për gabimet dhe ndryshimet në ligjet mjekësore.

**Materiale dhe metoda:** botime të rishikuara dhe të thjeshta.

**Rezultatet dhe diskutimet:** Ndryshimet e rëndësishme që kanë ndodhur për të ngritur terapinë me rrezatim si një modalitet të rëndësishëm në trajtimin e kancerit.

**Përfundime:** Rrezatimi është përdorur në mjekësi që nga zbulimi i tij në shekullin e 19-të. Që nga fillimi i shekullit të 20-të, rrezatimi është përdorur gjithnjë e më shumë për të diagnostikuar dhe trajtuar kancerin. Megjithëse, terapia me rrezatim shpesh dihej se shkatërronte indet e shëndetshme në përpjekjen e saj për të vrarë qelizat e kancerit, përparimet teknologjike kanë lejuar terapi të përpiktë dhe të saktë, duke ofruar një opsion të zbatueshëm si një kurë për individët e diagnostikuar me kancer.

**Fjalët kyçe:** inovacion; onkologji; rrezatimi; teknologji.

## STUDIM RASTI: BIOPSIA PULMONARE TRANSTORAKALE E UDHËHEQUR NË CT

*HANE PEPOSHI<sup>1</sup>, GERTA HALILAJ<sup>2</sup>*

*<sup>1,2</sup> Departamenti i Teknikë Laboratori Mjekësor dhe Imazheri, Fakulteti i Shkencave Mjekësore  
Teknike, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri.*

**Hyrje:** Tomografia e kompjuterizuar është një modalitet mjaft i vlefshëm për përdorim në procedurat intervencionuese përfshi biopsinë pulmonare. Ky modalitet është superior ndaj teknikave të tjera imazherike për të udhëhequr marrjen e materialit për biopsi për qëllime të diagnozës histologjike në rastet e suspektuara për kancer pulmonar.

**Qëllimi:** Qëllimi i këtij punimi është të theksojë rëndësinë e përdorimit të modalitetit CT në guidimin e biopsisë pulmonare.

**Materiale dhe metoda:** Ky punim është realizuar pranë Departamentit të Imazherisë, në Spitalin Universitar Shefqet Ndroqi. Gjatë muajit Mars 2022 u mor në vëzhgim një pacient (gjinia: mashkull, mosha: 67 vjec) me dyshim për kancer pulmonar. Pacienti ju nënshtrua ekzaminimit të CT. Imazhet u përfituan duke përdorur paisjen CT Siemens SOMATOM Definition Dual Source 128-slice, të cilat ndihmuan mjekun radiolog në marrjen e materialit të nevojshëm për biopsi. Pozicionimi i përshtatshëm i pacientit ishte shumë i rëndësishëm për të lehtësuar aksesin në lesion. Gjithashtu, u realizua një skanim post-procedurës për të evidentuar komplikacione të mundshme si pneumotoraksi ose hematoma.

**Përfundime:** Imazhet CT me rezolucion të lartë mundësuan një lokalizim preciz 3D të lezionit duke lejuar kështu operatorin të planifikojë aksesin e duhur duke përllogaritur me saktësi të lartë raportin e formacionit tumoral me strukturat përreth.

**Fjalë kyce:** pulmon, kancer, biopsi, CT.

## TRAJTIMI RADIOTERAPEUTIK I NJE TUMORI NE TRU

*FELJONA DOKA<sup>1</sup>, XHOANA ADEM<sup>2</sup>, ESTER OSHAFI<sup>3</sup>*

*<sup>1,2,3</sup> Departamenti i Teknikë Laboratori Mjekësor dhe Imazheri, Fakulteti i Shkencave Mjekësore  
Teknike, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri.*

**Hyrje:** Sëmundjet tumorale ose ndryshe neoplazike po shndërrohen në një ndër problemet themelore të shëndetësisë. Paralelisht me zhvillimin e këtyre sëmundjeve po zhvillohen dhe mënyrat për trajtimin e tyre. Trajtimi me radioterapi i një sëmundjeje tumorale përfshin përdorimin e rrezatimit jonizues me energji të rendit të kiloelektronvoltit dhe megaelektronvoltit, rrezatim ky i gjeneruar nga aparatura me burime të kobaltit (CO-60) apo akseleratorë linear LINAC, doza të tilla rrezatimi kërkojnë një kujdes të veçantë. Ky kujdes arrihet me anë të aplikimit të Sistemit të Planit të Trajtimit (TPS), i cili ka për qëllim shpërndarjen sa më preçize të dozës së caktuar për volumin target duke ruajtur në mënyrë sa më optimale indin normal ose organet vitale të shëndosha të cilat rrethojnë strukturën tumorale.

Meningiomat janë lloj i tumoreve intrakraniale te cilat përbëjnë 33% të të gjithë tumoreve parësore të trurit. Ndahen në tre shkallë: beninje, atipike dhe malinje. Radioterapia është e domosdoshme si trajtim postkirurgjikal në Meningiomën atipike dhe malinje me qëllim “pastrimin” e kufijeve rreth tumorit nga qelizat kancerogjene të cilat mund të kenë ngelur pas kirurgjisë dhe mund të behen shkaktare për një tumor sekondar. Më poshtë ne do të prezantojmë trajtimin e një meningiome me anë të teknikës së Radioterapisë.

**Materiale dhe metoda:** Plani i trajtimit fillon me përcaktimin e tufës së rrezatimit dhe cilësitë e saj duke përfshirë: Numrin e fushave, Energjinë e fushës, Këndin e gënit, Këndin e shtratit, Këndin e kolimatorit, Madhësitë e fushës, Dozat.

**Rezultate:** Pasi pacienti/ja diagnostikohet me Meningiomë tip 2 dhe vendos të kryej trajtim me Radioterapi i përcaktohet një plan trajtimi. Pacienti në fjalë do të rrezatohet për 28 ditë. Doza ditore që merr pacienti është afërsisht 2 Gy. Doza totale që do të marrë për 28 ditë është 55.8 Gy.

**Konkluzion:** Doza e marrë nga vëllimi i tumorit dhe organet përreth tregohen në histogramën dozë-volum. Pas verifikimit të planit të trajtimit është vënë re se organet rreth vëllimit tumoral kanë marrë një dozë minimale ndërkohë që vëllimi tumoral ka marrë dozën e përcaktuar në planin e trajtimit. Saktësia e trajtimit me Radioterapi është 5mm.

**Fjalë Kyçe:** Sistem i Planit të trajtimit (TPS), Histograma Dozë-Volum, Fushë rrezatimi, GTV, CTV, PTV, OAR (Organe në risk).